



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:152658

Datë: 27.10.2022

Numri i dokumentit: 03577013

P.nr.6/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, **Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit Adnan Lushtaku nga fsh.....-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.1993/2020 të datës 14.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, në të cilën prezent ishin prokurorja e shtetit Danjiell Batkoviq, i pandehuri A., L., dhe Mbrojtësi i tij me autorizim me shkrim Av.Q. R. si dhe përkthyesi i gjykatës Sh., H., më datën 25.10.2022 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa më datën 27.10.2022, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I pandehuri **A., L.**, nga babai ... dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë ..., i lindur me datë në ...-Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-pa fëmijë, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

- Ë S H T Ë F A J T O R -

- **SEPSE** : Me datë 03.11.2020 rrethë orës 14:55 min, në fshatin Klinë e Epërme, Rr.".....", me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka organizuar lojëra të fatit, në kuptim të dispozitave ligjore për të cilat nuk është lëshuar licenca, leja apo koncesioni nga ana e organit kompetent, ashtu që në lokalit (pa firmë të theksuar) me rastin e bastitjes nga ana e policisë është zënë në organizimin e lojërave të fatit, e me këtë rast edhe i janë marrë aparate dhe atë :Një (1) shtëpizë për kompjuter "Fujitsu" me numër serik ZLQS001691, Një (1) shtëpizë për kompjuter "Fujitsu" me numër serik ZLGG011556, Një (1) shtëpizë për kompjuter "HP" me numër serik CYC01146HP, Një (1) printer për tiketë të markës

“EPSON me numër serik 38400, Pesë (5) tiketa të gjetura në shportën e mbeturinave dhe Lexuesi për tiketë të markës “OCOM” me numër serik 16090936.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore dhe neneve : 4, 38, 39, 40, 42, 69, 70 dhe 92 të KPRK-së, e lidhur me nenet 115, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, 453 par.1 dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin e :

- G J Y K O N -

I.- Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim në bazë të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e tij i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **tetëqind (800.00) Euro**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mundet të paguajë dënimin e zëvendësuar me gjobë në shumë prej **tetëqind (800.00) Euro** në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë ai do të vuajë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

III.- Konform dispozitës ligjore nga neni 92 të KPRK-së lidhur me nenin 115 të KPP-së, gjykata urdhëron konfiskimin e përhershëm të sendeve :

1. Një (1) shtëpizë për kompjuter “Fujitsu” me numër serik ZLQS001691,
2. Një (1) shtëpizë për kompjuter “Fujitsu” me numër serik ZLGG011556,
3. Një (1) shtëpizë për kompjuter “HP” me numër serik CYC01146HP,
4. Një (1) printer për tiketë të markës “EPSON me numër serik 38400,
5. Pesë (5) tiketa të gjetura në sh[ortën e mbeturinave dhe
6. Lexuesi për tiketë të amrkës “OCOM” me numër serik 16090936, të cilat duhet të dërgohen në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar në Prishtinë, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30.00 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V.- Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte, andaj gjykata për kërkesë pasurore-juridike nuk vendosi fare.

- Arsyetim -

- Rrjedha e çështjes -

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm më datë 06.01.2022 në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1993/2020 datë 14.12.2021, kundër të pandehurit A., L., nga fsh.....-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së.

- Gjykata në këtë çështje penale më datë 21.10.2022 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, e cila ka qenë e hapur për publikun, në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Danijela Batkoviq, i pandehuri A., L., dhe Mbrojtësi i tij me autorizim me shkrim Av.Q., R., si dhe përkthyesi i gjykatës Shaban Hajra, ashtu që të pandehurin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale dëshiron të mbrohet përmes mbrojtësit të tij Av.Q., R.,

- Vlerësimi i pranimit të fajësisë -

- Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, gjykata të pandehurin e ka njoftuar hollësisht me pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, njëherësh shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do t'i përsërisë veprimet e tilla, po ashtu i propozoi gjykatës që ndaj tij t'i shqiptojë ndonjë dënim sa më të butë pasi që, lidhur me veprimet e tij është penduar thellësisht për çka sinqerisht kërkoi falje.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e kërkojë mendimin nga prokurorja e shtetit, e cila me këtë rast deklaroi se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe i propozoi gjykatës që ta aprovoj këtë pranim fajësie nga i pandehuri njëheritë të njëjtën ta merrë si rrethanë lehtësuese.

- Mbrojtësi i të pandehurit mes tjerash deklaroi se, e mbështetë deklarin e të mbrojturit të tij pasi që është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me të, se i njëjti ndihet thellësisht i penduar dhe kërkoi nga gjykata që të merrë si rrethanë lehtësues faktin se i pandehuri është i moshës së re dhe se i njëjti ka bashkëpunuar me organet e shtetit.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe pas marrjes së mendimit nga prokurorja e shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 248 par.4 lidhur me par.1 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze ngase, konsideroi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i

pandehuri dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

- Gjendja faktike e vërtetuar -

- Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i pandehuri, pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës në raport me të pandehurin, siç ishin : Raporti i oficerit policor-.... Nr.2020-BF-0338 të datës 03.11.2020, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit Nr.2020-BF-0338 të datës 03.11.2020 dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit-... Nr.2020-BF-0338 të datës 03.11.2020 dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve Nr.2020-BF-0338 të datës 03.11.2020 lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Aktvendimi i Komuna Skenderaj-Drejtoria për Inspektion Nr.13-334/01-0047598/20 i datës 04.11.2020, Përmbajtja e dosjes së teknikës kriminalistike Nr.2020-BF-0338 të datës 03.11.2020 së bashku me Fotoalbumin e vendit të ngjarjes punuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Raporti i ekspertimit Nr.AKF-2020-0358 i datës 17.12.2021 punuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë si dhe nga vështrimi në të gjitha shkresat tjera të lëndës.

- Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme si dhe vetëpranimi i fajësisë nga i pandehuri, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të tij përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-Organizimi i sjkemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së, ngase i njëjti me datë 03.11.2020 rrethë orës 14:55 min, në fshatin ..., Rr."....", me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka organizuar lojëra të fatit, në kuptim të dispozitave ligjore për të cilat nuk është lëshuar licenca, leja apo koncesioni nga ana e organit kompetent, ashtu që në lokalin (pa firmë të theksuar) me rastin e bastitjes nga ana e policisë është zënë në organizimin e lojërave të fatit, e me këtë rast edhe i janë marrë aparate dhe atë : Një (1) shtëpizë për kompjuter "Fujitsu" me numër serik ZLQS001691, Një (1) shtëpizë për kompjuter "Fujitsu" me numër serik ZLGG011556, Një (1) shtëpizë për kompjuter "HP" me numër serik CYC01146HP, Një (1) printer për tiketë të markës "EPSON me numër serik 38400, Pesë (5) tiketa të gjetura në shportën e mbeturinave dhe Lexuesi për tiketë të markës "OCOM" me numër serik 16090936, për çka gjykata gjeti se i pandehuri në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit -

- Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të pandehurin si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, pastaj pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët si dhe premtimin gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe se nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese në rastin konkret gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes së të pandehurit, ngase edhe përkundër faktit se lojërat e fatit janë ndaluar me Ligjin Nr.06/L-155 për Ndalimin e lojërave të fatit, i pandehuri në kundërshtim me këtë ligj ka zhvilluar aktivitetet përkatësisht ka organizuar lojërat e fatit.

- Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të pandehurit t'i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim me pëlqimin e tij si dhe në bazë të nenit 44 të KPRK-së i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej tetëqind (800.00) euro të cilin do ta paguajë në afat prej 30 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ngase, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e vitkimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për konfiskim -

- Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 92 të KPRK-së lidhur me nenin 115 të KPP-së, ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të sendeve : Një (1) shtëpizë për kompjuter "Fujitsu" me numër serik ZLQS001691, Një (1) shtëpizë për kompjuter "Fujitsu" me numër serik ZLGG011556, Një (1) shtëpizë për kompjuter "HP" me numër serik CYC01146HP, Një (1) printer për tiketë të markës "EPSON me numër serik 38400, Pesë (5) tiketa të gjetura në shportën e mbeturinave dhe Lexuesi për tiketë të markës "OCOM" me numër serik 16090936, pasi që ka gjetur se kanë rezultuar se janë sende të cilat kanë mundësuar dhe janë përdorur me rastin e kryerjes së kësaj veprë penale andaj, si rrjedhojë gjykata vendosi që sendet e sekuestruara përkohësisht dhe atë të përcaktuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi t'i konfiskojë.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte, andaj për kërkesën pasurore juridike gjykata nuk vendosi fare në këtë procedurë penale.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ
- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.6/2022 me datë 27.10.2022.

Procesmbajtësja,
Floriye Gucati

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme